



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 27 / prot

Koplik më: 11 / 10 / 2021

PROJEKT - V E N D I M

Nr _____, Datë ____ / ____ / 2021

PËR

MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/NE PËRDORIM TE SIPERFAQES
PYJORE/KULLOSORE NE NJËSINE ADMINISTRATIVE KELMEND ,BASHKIA
MALËSI E MADHE .

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe , në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 64 pika “c”, ligjin nr.48/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9385 datë 04.05.2005 “ Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, si dhe VKM nr.1353 dt.10.10.2008 i ndryshuar “Për rregullat për paraqitjen e kërkeses,mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik,kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”,VKM nr.1374 10.10.2008 të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”,Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në perdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , VKM nr.1064 dt.22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391 dt.21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” , lidhja nr.2 pika 11/5 dhe 6 ; “Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe ,si dhe ndërtim kanalesh (uji,nafte,gazi,tensioni elektrik etj.) si dhe bazuar në VKM. 438, datë 8.06.2016 “ Për Kriteret dhe Rregullat e Shfrytëzimit të Pyjeve dhe të Shitjes së Materjalit Drusor e të Prodhimeve të Tjera Pyjore e Jopyjore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1110 Prot.

Koplik ,më: 11/10/2021

Relacion
PËR

**MIRATIMIN E DHNIËS ME QIRA/NË PËRDORIM TË SIPERFAQËS
PYJORE/KULLOSORE NE NJËSINË ADMINISTRATIVE KELMEND ,BASHKIA
MALËSI E MADHE .**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 germa c .

Të nderuar këshilltarë

Më lejoni tu paraqes relacionin sqarues për raportin mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim fondi pyjor për rikonstruksion HEC-i nga shoqëria “WTS Energji” sh.p.k mbi lumin e Cemit Tamare, njësia administrative Kelmend ,Bashkia Malësi e Madhe .

Ky studim tekniko ekonomik ka për objekt kërkimin për rikonstruksionin e HEC-it ne Tamare per shtrim tubi per furnizimin me uje te HEC-it ne Tamare. Mbeshtetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor kullosor rezulton që gjatësia e kanalit është 1.560 km dhe gjerësia 1.420mm shtrihet në ngastrat/nënngastrat; 5d në ekonominë pyjore“ Lugina e Cemit“ , dhe është në pronësi të Bashkisë Malësi e Madhe .

VKM nr.1064 dt.22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391 dt.21.06.2006 te Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” , lidhja nr.2 pika 11/5 dhe 6 ; “Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe ,si dhe ndërtim kanalesh (uji,nafte,gazi,tensioni elektrik etj) .

Vlera për ndërtim kanali dhe shtrim tubacioni është 226 200 leke.

Bashkangjitur gjeni raportin mbi studimin tekniko ekonomik.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

